



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 korrik 2020
Nr. ref.:RK 1580/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI77/19

Parashtrues

Musa Islami

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, AA. nr. 99/2018, i 12 shkurtit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Musa Islami, nga fshati Dyç, komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA. nr. 99/2018, të 12 shkurtit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat], 28 [Ndalimi i Skllavërisë dhe i Punës së Detyruar] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 maj 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 17 maj 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
7. Më 17 qershor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Gjykatën e Apelit të Kosovës për regjistrim të kërkesës.
8. Më 10 qershor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 20 shkurt 2014, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave përmes Vendimit nr. 09/14, kishte caktuar parashtruesin e kërkesës si Ushtrues Detyre i Udhëheqësit në Divizionin Qendror Harmonizues për Menaxhimin Financiar dhe Kontroll Qendror Harmonizues, nga pozita e zyrtarit në të njëjtin Divizion.
10. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesit të kërkesës, edhe pas këtij vendimi nuk i ishte harmonizuar paga me Udhëheqësit në Divizione të tjera, nga ana e Ministrisë së Financave.

11. Më 28 tetor 2014, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Financave duke kërkuar *“nivelizim të pagës dhe trajtim”*.
12. Më 3 nëntor 2014, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Financave përmes Vendimit [Nr-KA-2014] hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se, i njëjti *“merret vetëm me shqyrtimin e ankesave e jo të kërkesave dhe se komisioni nuk ka kompetencë të vendosë për nivelizimin e pagave dhe trajtim”*.
13. Më 19 nëntor 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPSHCK) duke kërkuar që Ministria e Financave të trajtojë me pagë të njëjtë me udhëheqësin tjetër të divizionit, në kuadër të të njëjtit Departament.
14. Më 19 janar 2015, KPSHCK-ja përmes Vendimit [A/02/589/2014] hodhi poshtë si të palejuar ankesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se e njëjta është paraqitur pas afatit të paraparë ligjor.
15. Më 20 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Vendimit të KPSHCK-së [A/02/589/2014], të 19 janarit 2015, duke pretenduar aplikim jo të drejtë të dispozitave ligjore dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike.
16. Më 10 janar 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [A. nr. 328/15] refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës. Në arsyetimin e saj, Gjykata Themelore në Prishtinë, Vendimin e KPSHCK-së [A/02/589/2014] të 19 janarit 2015 e konsideroi si të drejtë dhe të ligjshëm, duke shtuar se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë. Në arsyetim, ndër të tjera, theksohet se *“megjë afati për ankim rrjedh nga data kur ankuesi merr njoftim se i janë cenuar të drejtat e tij e që për ankuesin ky fakt është paga e parë e dalur në xhirollogarinë e tij me dt. 01.04.2014 pasi që ka marrë vendimin për caktimin UD për pozitën me dt. 20.02.2014 e ku ankuesi tek punëdhënësi i tij ankesën e ka paraqitur më dt.28.10.2014. nga kjo gjendje faktike e vërtetuar nënkuptohet se kërkesa e tij për kompensimin e mjeteve për ndryshimin e koeficientit për pozitën e caktuar te punëdhënësi është paraqitur jashtë çdo afati ligjor [...]”*.
17. Më 6 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë [A. nr. 328/15], të 10 janarit 2018, duke pretenduar vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të procedurës kontestimore.
18. Më 12 shkurt 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA. nr. 99/2018] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës duke e konsideruar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë [A. nr. 328/15] si të rregullt dhe tërësisht të bazuar në ligj. Sa i përket pretendimit për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, kjo Gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, duke theksuar se *“provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat], 28 [Ndalimi i Skllavërisë dhe i Punës së Detyruar] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“nëse kam humbur të drejtën e ankesës time për një muaj unë kam kryer këtë funksion 3 vjet pa ndërpre deri me datën e shpalljes së konkursit të rregullt, që do të thotë 41 muaj kam të drejtë të marrë kompensim”*.
21. Parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se ai nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë sepse Ministria e Financave nuk e ka bërë nivelizimin e pagës së parashtruesit, edhe pasi që është emëruar si Ushtrues Detyre i Udhëheqësit në Divizionin Qendror Harmonizues për Menaxhimin Financiar dhe Kontroll Qendror Harmonizues. Parashtruesi i kërkesës është kompensuar me pagë në koeficient më të vogël se udhëheqësit e Divizionit tjetër në kuadër të të njëjtit Departament.
22. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të anulojë vendimin e kontestuar dhe vendimet e tjera që i kanë parapri këtij të fundit, si dhe të kompensohet për periudhën prej 41 (dyzet e një muajsh) prej se është emëruar në pozitën e lartcekur.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit, i cili parasheh:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

26. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston aktet e një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, përmes vendimeve të gjykatave të rregullta, në pajtim me kushtet që kërkojnë nga neni 48 i Ligjit, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
27. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë plotësuar kriteret e parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, ku përcaktohet se:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.
28. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat], 28 [Ndalimi i Skllavërisë dhe i Punës së Detyruar] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
29. Gjykata vë në pah se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, në thelb, kanë të bëjnë me interpretimin nga gjykatat e rregullta të dispozitave përkatëse të së drejtës materiale si dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike.
30. Sipas parashtruesit të kërkesës, këto të drejta i janë shkelur sepse ai nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë nga ana e punëdhënësit të tij, Ministrisë së

Financave, e cila edhe pasi që parashtruesi i kërkesës është emëruar si Ushtrues Detyre i Udhëheqësit në Divizionin Qendror Harmonizues për Menaxhimin Financiar dhe Kontroll Qendror Harmonizues, nuk e ka nivelizuar pagën e parashtruesit të kërkesës, me pagën e udhëheqësit në Divizionin tjetër në kuadër të të njëjtit Department. Parashtruesit të kërkesës i kishte mbetur paga e njëjtë të cilën e ka pasur si zyrtar në Ministrinë e Financave para se të emërohej si Ushtrues Detyre.

31. Gjykata vëren se të njëjtat pretendime parashtruesi i kërkesës i kishte paraqitur edhe para gjykatave të rregullta.
32. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës e ndërtoi rastin e tij mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi vërtetimin e fakteve dhe interpretimin e gabuar të ligjeve, nga ana e gjykatave të rregullta. Gjykata rikujton se këto pretendime kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35).
33. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së dhe po ashtu edhe me praktikën e saj tanimë të konsoliduar, Gjykata rithekson se është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të ligjit procedural dhe material dhe se nuk mund të bëhen vlerësime abstrakte se pse një gjykatë e rregullt ka vendosur në një mënyrë të caktuar e jo në një tjetër (shih rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
34. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë*, kërkesa nr. 65167/01, Vendim për papranueshmëri, i 30 qershorit 2005).
35. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit ka dhënë arsye të qarta dhe të mjaftueshme për gjetjet dhe konstatimet e saj. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj i ishte përgjigjur të gjitha pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.
36. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet Aktgjykimit [AA. nr. 99/2018] të Gjykatës së Apelit e cila në arsyetimin e saj theksoi se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore

A. nr. 328/15 i 10 janarit 2018, nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konflikt Administrativ. Më tutje, lidhur me pretendimin e parashtruesit se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht, Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj theksoi se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë duke u mbështetur në prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara dhe se parashtruesi i kërkesës me asnjë provë nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij. Më tutje, lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit theksoi se *“padiësi ka parashtruar kërkesë në Ministrinë e Financave më datë 28.10.2014, me kërkesë që Ministria ta trajtojë me pagë të njëjtë me udhëheqësin e divizionit tjetër në këtë departament. Padiësit ka filluar t’i rrjedh afati nga momenti kur i ka dal paga në xhirollogarinë e tij bankare, përkatësisht nga data 01.04.2014, ndërsa i njëjti kërkesën e ka parashtruar me dt.28.10.2014 pra jashtë afatit të paraparë me ligj ku neni 8 par.2 i Rregullores nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave ku përcaktohet se “Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës [...]”*.

37. Në dritën e kësaj, Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë (shih rastin e Gjykatës KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu, rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjokaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
38. Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
39. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe që me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.
40. Si përfundim, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 10 qershor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi